



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/260

Datë: 05.07.2018

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenin 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008), nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore, nenit 19 paragrafi 1 pika a, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871, datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes së VII (shtatë) të mbajtur me datë: 03.07.2018 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Malishevës, që Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të shqyrtojë zbatimin e Udhëzimit Administrativ të (MASHT) nr.02/2016, për aktivitetet jashtëshkollore nga Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevës, lidhur me organizimin e ekskursionit të nxënësve në vitin shkollor 2017/2018.
2. Obligohet Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport që pas përfundimit të punës sipas autorizimit të Kuvendit të përgatitë raport me shkrim dhe i njëjti t'i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtorisë për Arsim dhe Edukim.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
DKAE-së
MAPL-së.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina